



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:279816 C. nr. 2005/2019
Datë: 12.03.2024
Numri i dokumentit: 05441249

GJYKATA THEMELORE PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha në çështjen kontestimore të paditësit, J.Xh. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson avokati S.K. nga Prishtina, kundër të paditurve: M.H. nga Gjakova, H. K. dhe B.K. që të dy nga Prizreni, A.Q., K.Q. dhe Sh.Q. të tre nga Prizreni, S.Q. dhe K.Q. që të dy nga Prizreni, për vërtetimin e pronësisë, në seancën publike përgatitore, me datë 11.03.2024, morri këtë:

A K T G J Y K I M

Ndërpritet procedura në këtë çështje juridike, për shkak të vdekjes së të paditurve H.K., B.K., K.Q. dhe S.Q.

Procedura do të vazhdohet, pasi që trashëgimtarët e tani të ndjerave e marrin përsipër procedurën, apo kur gjykata i thërrit ta bëjnë këtë pas propozimit të palës kundërshtare.

A r s y e t i m

Paditësit me padinë e paraqitur kundër të paditurve ka kërkuar të vërtetohet se është pronar i ngastrës kadastrale nr. ZK Prizren.

Në seancën përgatitore të datës 11.03.2024, palët djali i të ndërgjyqëse njoftojnë gjykatën që të paditurit e lartcekur tani janë të ndjerë. ky fakt u pohua nga të gjitha palët ndërgjyqëse.

Pasi që të paditurit H.K., B.K., K.Q. dhe S.Q. kanë vdekur, gjykata në kuptim të nenit 277 par. 1 germa (a) dhe nenit 280 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, e ndërpreu procedurën duke i udhëzuar palët për mënyrën e vazhdimit të procedurës.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

C. nr. 2005/2019 datë 11.03.2024

Gj y q t a r i,
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.